



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 23 Prill 2021

Raport i Ndërmjetëm

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Mbi disa gjetje dhe konkluzione paraprake nga vëzhgimi i disa aspekteve të procesit parazgjedhor, në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të dt. 25 Prill 2021

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është organizatë jofitimprurëse, misioni i të cilës është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë. Duke vlerësuar ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur si një të drejtë themelore kushtetuese, KShH ka monitoruar proceset zgjedhore të realizuara në vendin tonë që prej vitit 1996.

Për monitorimin e procesit zgjedhor të Zgjedhjeve Parlamentare 2021, KShH ka angazhuar 206 vëzhgues afatshkurtër dhe afatgjatë, të akredituar nga KQZ, në 14 Bashki të vendit, përkatësisht në: Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Fier, Shkodër, Malësi e Madhe, Dibër, Lezhë, Pogradec, Berat, Kukës, Gjirokastrë.

Ky raport pasqyron disa prej gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake nga vëzhgimi i procesit parazgjedhor, në 9 Bashki të vendit për periudhën: Tetor 2020 – Prill 2021¹ dhe në 5 Bashki të tjera² për muajt Mars - Prill 2021. Vëzhgimi është realizuar në kuadër të zbatimit të dy nismave, përkatësisht "Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen" mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian dhe "Drejt integritetit më të mirë të kandidatëve, për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme", mbështetur nga Republika Federale Gjermane.

Në mënyrë të përmbledhur, nga monitorimi i disa aspekteve të rëndësishme të procesit parazgjedhor rezulton se:

Reforma Zgjedhore

1. Zgjedhjet Parlamentare të dt.25 Prill zhvillohen në kushtet e Pandemisë globale, për shkak të virusit "Covid 19". Me datë 13.04.2021 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratoi Protokollin "Lidhur me masat anti Covid-19 gjatë procesit zgjedhor dhe ditës së votimeve³". KShH sugjeron që zbatimi i këtij protokollit nuk të cenojë të drejtat e vëzhguesve të

¹ Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Fier, Shkodër, Kukës, Gjirokastrë

² Malësi e Madhe, Dibër, Lezhë, Pogradec, Berat,

³ <https://ata.gov.al/2021/04/20/publikohet-protokoll-i-masave-antikovid-per-procesin-zgjedhor-maskat-te-detyrueshme/>



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

akredituar, për të monitoruar pa pengesë dhe në mënyrë pro-aktive, të gjitha fazat e procesit zgjedhor, duke përfshirë këtu procesin e votimit dhe të numërimit të votave⁴.

2. Rreth 9 muaj para datës së zgjedhjeve, caktuar me Dekretin e Presidentit të RSH, u miratua Reforma Zgjedhore nga Kuvendi i RSH (përkatësisht më dt. 23 Korrik 2020). Kjo reformë u realizua në kushtet e një atmosfere të polarizuar politike, si dhe nuk respektoi standardet e një konsultimi publik dhe gjithëpërfshirës dhe transparence të plotë. Një javë më pas, Kuvendi miratoi ndryshimet Kushtetuese, të cilat i paraprinë ndryshimeve të mëtejshme në një hark të ngushtë kohor të Kodit Zgjedhor dhe që mundësuan ndryshimin e sistemit zgjedhor. Sistemi zgjedhor që aplikohet në këto zgjedhje parlamentare, është sistemi proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar (i njohur ndryshe si sistemi me lista të hapura pjesërisht, në jo më pak se dy të tretat e listës). Paketa ligjore e ndryshimeve që pësoi Kodi Zgjedhor për ndryshimin e sistemit në Tetor të Kodit Zgjedhor në Tetor 2020, nuk iu nënshtrua as formalisht konsultimit publik. Vlen të theksohet se, KShH ka kritikuar nenin 67, pika 3 të Kodit Zgjedhor, për shkak se cënon standartet ndërkombëtare për trajtimin e barabartë të kandidatëve. Në zbatim të këtij neni, nga monitorimi i kryer në listat shumëmbrore të kandidatëve për deputet, rezultoi se kryetarët e 7 subjekteve zgjedhore kanë ushtruar mundësinë e kandidimit në më shumë se një zonë zgjedhore, duke krijuar pabarazi me kandidatët e tjerë brenda të njëjtit subjekt/koalicion zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), si organi më i lartë i administrimit zgjedhor, u ngrit në një kohë të shkurtër, afro 5 muaj nga dita e zgjedhjeve. Ky fakt krijoi një ngarkesë në rritje të këtij institucioni, i cili ndër të tjerash duhet të krijonte praktikën e nevojshme administrative dhe të miratonte aktet normative për administrimin e procesit, në kushtet e zbatimit të ndryshimeve të konsiderueshme që pësoi Kodi Zgjedhor. Kjo ngarkesë ka reflektuar dhe në konsultimin në një kohë tepër të shkurtër të projekt-akteve të Komisionit me OSHC, çka e ka pamundësuar efektivitetin e konsultimit dhe ofrimin e kontributeve cilësore prej tyre.

4. KShH vlerëson në tërësi pro-aktivitetin dhe dinamikën e punës së KQZ-së, për të administruar me ritmet e duhura mbarëvajtjen e procesit parazgjedhor, të votimit dhe numërimit. Më gjatë, vendimmarrje të caktuara në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, sidomos në vendimet lidhur me përcaktimin e fletës së votimit apo regjistrimin e listës shumëmbrore të kandidatëve për deputet, vihet re një ndarje e ngushtë e anëtarëve (3 me 2), e cila mund të jetë një tregues i mundshëm se këto vendimmarrje janë marrë nën ndikimin e influencave politike⁵.

5. Është pozitiv fakti që në fillim të vitit 2021, KQZ miratoi programin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, si dhe ka patur një angazhim pro-aktiv për

⁴ <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinkit/photos/pcb.3619278048195699/3619273224862848/>

⁵ Sipas raporteve të OSBE/ODIHR, vendimmarrja e ngushtë sipas linjave politike shfaq natyrën e politizuar të diskutimeve të KQZ-së. Shih Raportin Përfundimtar të Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore, 21 Qershor 2015, OSBE/ODIHR, 8 shtator 2015, Varshavë, fq 7



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ndërgjegjësimin e qytetarëve me anë të medias. Mgjth, ky proces mund të kishte nisur më herët për shkak të rëndësisë së veçantë që mbart.

Listat e zgjedhësve

6. Listat e përbërësve zgjedhorë dhe ato përfundimtare rezultojnë të jenë afishuar në përputhje me parashikimet e nenit 51 pika 4 të Kodit Zgjedhor, pranë zyrave të gjendjes civile ose në ambientet e Njesisë Administrative. Megjithatë vijon të mbetet problematike aksesimi i lirë i qytetarëve tek listat, veçanërisht në disa prej Qendrave të Votimit, për shkak të kufizimeve të orarit zyrtar të ambienteve ku ato ndodhen (kryesisht shkolla), vendosjes së tyre në lartësi të papërshtatshme, apo dëmtimit si rezultat i kushteve atmosferike. Njoftimi me shkrim i zgjedhësve në banesë sipas nenit 52 të KZ, është një moment i rëndësishëm i mirëadministrimit të procesit, pasi garanton njohjen e tyre paraprake me QV ku votojnë. Ashtu si në të kaluarën, KShH vëren se njësitë e qeverisjes vendore nuk e kanë përmbushur këtë detyrim brenda afatit ligjor, pavarësisht alokimit të fondit përkatës nga Ministria e Brendshme⁶.

Vota e diasporës

7. Votimi për shtetasit shqiptarë që kanë vendbanim të përhershëm jashtë vendit (diaspora) u prezantua si risi në Kodin Zgjedhor, por në praktikë, ky proces rezultoi i vështirë, delikat dhe i pamundur për t'u bërë funksional sipas KQZ-së, në Zgjedhjet Parlamentare të dt.25 Prill 2021. KShH shpreh shqetësimin e tij lidhur me këtë fakt, duke vërejtur që kjo situatë u krijua, jo vetëm për shkak të formulimeve të përgjithshme dhe të mjegullta në Kodin Zgjedhor që sanksiononte votën e emigrantëve me vendbanim të përhershëm jashtë vendit, por njëkohësisht edhe për mungesën rakordimit nga ligjvënësi, të parashikimeve ligjore me infrastrukturën e nevojshme që duhet të garantonte zbatimin e tyre në praktikë. Konkretisht, të dhënat në Regjistrin e Gjendjes Civile të adresave të shtetasve shqiptarë jashtë vendit rezultuan në numër tepër të ulët, ndërkohë që ky përbënte një kriter thelbësor për të mundur realizimin e ushtrimit të së drejtës së votës sipas Kodit Zgjedhor.

8. Vetëm 6 ditë para zgjedhjeve (19 Prill 2021), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka nxjerrë një urdhër për karantinimin e personave që vijnë në vendin tonë, përmes rrugëve ajrore, tokësore dhe detare nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia⁷. Në vlerësimin e KShH-së, ky urdhër shtrin efektet edhe ndaj shtetasve shqiptarë që mund të kërkojnë të vijnë në vend dhe të ushtrojnë të drejtën e votës dhe që jetojnë në endet fqinjë, Maqedonia e Veriut, Greqia apo të cilët përdorin tranzit këto shtete për të hyrë në vend. Në kushtet kur vota e diasporës nuk u siguroi sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, KShH vëren me shqetësim se këto rregulla privojnë shtetasit shqiptarë nga e drejta e votës (psh ky urdhër mund të ishte nxjerrë më herët në kohë, mund të ishte kërkuar që këta shtetas të nënshtroheshin testeve të kontrollit nëse rezultojnë

⁶ Në disa raste, qytetarët raportojnë të jenë njoftuar vetëm verbalisht nga ana e administratorëve të lagjeve.

⁷ <http://webmail.ahc.org.al/webmail/api/download/attachment/ahc.org.al/e.skendaj/c2e539bb-d0df-40da-91a8-edabf656e7aa/6493/0-1/urdher-2021-04-19-219.pdf?version=24384&sid=856bbd26fbde585d6646136f6e9be86d823f4521dd701033979a8b667e73b097&mode=view>



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ose jo mbartës të Covid 19, para se të hynin në vend, etj). KShH i sugjeron Ministrisë së Shëndetësisë të rishikojë këtë urdhër, për të parashikuar masa efektive dhe proporcionale që garantojnë të drejtën e votës paralelisht me jetën dhe shëndetin e shtetasve shqiptarë që ndodhen ose jetojnë jashtë vendit dhe hyjnë në vendin tonë, nga Greqia apo Maqedonia e Veriut.

Fushata Zgjedhore dhe Ndalimi i përdorimit të Burimeve Shtetërore

9. Fushata zgjedhore rezulton se ka filluar para afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor (një muaj para datës së zgjedhjeve). Shqetësues është fakti që kjo fushatë është shoqëruar nga një klimë tepër e polarizuar politike si dhe me elementë të gjuhës së urrejtjes, me elementë të diskriminimit të gjinisë femërore apo në cenim të dinjitetit të kandidatëve të propozuar nga subjektet zgjedhore “kundërshtare”. Nga monitorimi është evidentuar organizimi i takimeve informale në ambiente të mbyllura apo të jashtme, në cënim të protokolleve dhe masave anti Covid 19.

10. Koordinatorët lokalë raportojnë në disa Bashki⁸, “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Gjithashtu, raportohet gjatë fushatës zgjedhore se ka patur përfshirje të punonjësve të administratës publike gjatë orarit zyrtar të punës, në mbledhjet apo takimet e subjekteve zgjedhore në kundërshtim me nenin 91 të KZ⁹. KShH ka sinjalizuar KQZ-në, duke i sugjeruar kryerjen e verifikimeve të mëtejshme dhe fillimin e hetimit administrativ (dhe në varësi të hetimit, zbatimin e sanksioneve përkatëse), për të dhënat e përcjella nga koordinatorët lokalë apo në media, se ka përdorim të burimeve shtetërore gjatë fushatës (në cënim të ndalimeve ligjore). Vlen të veçojmë shkresën drejtuar KQZ-së në dt.7 Prill 2021, për vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës për përjashtimin e bizneseve nga detyrimi për pagesën e tarifës së zënies së hapësirës publike si dhe shkresën drejtuar në dt. 17 Prill për Bashkitë Pogradec dhe Dibër¹⁰. Lidhur me këto kërkesa, nuk kemi ende përgjigje.

11. Sa i takon afishimit të materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore, vërehet së Bashkia Dibër, Tiranë, Korçë, Elbasan dhe Durrës nuk kanë respektuar detyrimin ligjor për publikimin e vendimmarrjes, për caktimin e vendeve të afishimit të këtyre materialeve, në kundërshtim me nenin 79 të KZ. Sipas Udhëzimit nr. 6, datë 23/03/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në fasadat e institucioneve publike. Përgjatë muajit mars, koordinatorët lokalë raportojnë se zyrat zgjedhore në territorin e disa Bashkive të monitoruara (Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Elbasan) janë ngritur para afatit ligjor të fushatës zgjedhore dhe pëmbajnë elementë të fushatës si logot,

⁸ Bashkitë Pogradec, Dibër, Malësi e Madhe, Tiranë dhe Durrës.

⁹ Bashkitë Dibër dhe Durrës.

¹⁰ Shkresa dt.7 Prill 2021, e cila mund të aksesohet në këtë link
<http://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/04/20210407164839700.pdf>

Shkresa e dt.17 Prill, e cila mund të aksesohet në këtë link

<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/pcb.3603540183102819/3603539149769589/>



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

posterat dhe motot e subjekteve zgjedhore, në kundërshtim me nenin 79 të KZ¹¹. Gjithashtu, janë shënuar parregullsi sa i takon distancës më të vogël se 300m ndërjmet zyrave zgjedhore dhe organeve të administratës zgjedhore¹². Janë vërejtur raste kur, institucionet publike kanë promovuar në rrjetet sociale subjekte zgjedhore apo kandidatë të caktuar, si psh ceremonia e inagurimit të Maternitetit të ri të Lezhës, në të cilën morën pjesë kandidatë të caktuar të veshur me indikacione promocionale zgjedhore¹³.

Incidentet dhe denoncimet për shitblerjen e votës

12. Gjatë procesit parazgjedhor, në median e shkruar dhe audiovizive, veçanërisht gjatë javës së fundit, pak ditë para zgjedhjeve, janë raportuar disa incidente, **për një pjesë të të cilave**, nuk është ende e qartë nëse lidhen ose jo detyrimisht me procesin zgjedhor. Referuar të dhënave të medias, por dhe koordinatorëve lokalë në terren, raportohen sinjalizime për fenomenin e shitblerjes së votës nga subjektet zgjedhore në Tiranë, Vaqarr, Elbasan, Vlorë, Dibër dhe Shkodër¹⁴. Incidentet e ndodhura sipas medias, raportohet në disa raste të jenë të lidhura me sinjalizimet apo pretendimet për shitblerjen e votës, të cilat kanë sjellë dhe përplasje fizike apo me armë midis mbështetësve të subjekteve zgjedhore, sikurse ishte ngjarja me pasoja të rënda në jetën dhe shëndetin e shtetasve në qytetin e Elbasanit. Gjithashtu, është evidentuar rasti i depozitimit të një kallëzimi pranë SPAK ndaj zyrtarëve lokalë në Berat nën akuzën e “Korrupsionit pasiv në zgjedhje”.

Lidhur me këto raste, KShH vëren se jo gjithmonë ka patur transparencë nga stukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, sikurse ka ndodhur në rastet e tjera ku publiku është informuar për veprimet paraprake të verifikimit, dinamikës së ngjarjes, nëse ka patur referim të çështjes në prokurori apo procedim penal të shtetasve¹⁵. Transparenca në kohë ndaj publikut është e

¹¹ Ku parashikohet afishimi i materialeve propagandistike pranë zyrave zgjedhore vetëm përgjatë fushatës zgjedhore (duke filluar nga data 26 mars). Gjithashtu, vëzhguesit kanë konstatuar se në Bashkinë Tiranë raportohet shkelje e udhëzimit, pasi në fasadën e Universitetit Politeknik të Tiranës ka materiale propagandistike të subjektit zgjedhor PD. Në Bashkinë e Gjirokastrës raportohet të ketë shfaqje të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor PS në fasadën e Pallatit të Sportit.

¹² Kryesisht në KZAZ-të në Berat dhe Pogradec.

¹³ Kjo situatë rezulton e përsëritur edhe së fundmi, gjatë inagurimit të Spitalit Rajonal të Fierit ku u evidentuan materiale propagandistike dhe prania e kandidatëve për deputetë të një prej subjekteve zgjedhore (PS).

¹⁴ https://shqiptarja.com/lajm/video-ku-kandidati-i-lsi-blen-vota-ne-tirane-mos-e-ngri-zerin-se-kemi-kontrolle-ti-merr-leket-me-jep-voten?s=last_article

<https://exit.al/arrestohen-2-persona-per-blerje-vote-ne-vlore/>

<https://www.reporter.al/pergjaket-fushata-ne-elbasan-vritet-politikani-lokal-pjerin-xhuvani/>

<https://www.balkanweb.com/ja-se-si-po-tentohet-blerja-e-votes-nga-ps-ne-vaqarr-kreu-i-frpd-belind-kellici-publikon-pamjet-meta-e-pergez-on-mbani-shenim-cdo-emer-dhe-dokumentoni-cilindo/>

<https://kohajone.com/po-blejne-vota-2-persona-kapen-mat-ne-shkoder-me-listen-dhe-fleten-e-psd-se-te-shenuar/>

<https://www.reporter.al/policia-e-dibres-shoqeron-dy-te-dyshuar-per-blerje-vote/>

¹⁵ Psh, në dt. 23/04/2021, Drejtoria Vendore e Policisë Dibër në njoftimin për media, informon se është realizuar arrestimi në flagrancë i 2 shtetasve për veprat penale ‘Korrupsioni aktiv në zgjedhje’ kryer në bashkëpunim dhe ‘Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore’. Në dt.22 Prill, në një komunikatë për mediat nga Drejtoria e Policisë së Elbasanit, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, shpjegoi edhe dinamikën e ngjarjes <https://tvklan.al/ardi-veliu-11-te-arrestuar-per-masakren-ne-elbasan-si-ndodhi-perplasia-e-armatosur/>, etj.



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

rëndësishme sa i takont besimit të qytetarëve tek organet ligjzbatuese dhe institucioni demokratik i zgjedhjeve.

13. Përveç nevojës që diktohet ndaj organit të prokurorisë për të hetuar me pro-aktivitet (dhe jo vetëm bazuar në sinjalizime por dhe me nismë), si edhe objektivitet, vigjilencë maksimale, transparencë, në mënyrë të plotë dhe brenda një kohe sa më të shpejtë, çdo veprë penale në fushën e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, KShH risjell në vëmendje kërkesat për integritetin e lartë profesional dhe moral, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë që duhet të shoqërojnë prokurorët dhe gjyqtarët në kryerjen e detyrës së tyre, konform parimeve të reformës në drejtësi. Gjithashtu, KShH vlerëson se për incidente të kësaj natyre fjalën e fundit e ka drejtësia, ndaj edhe pse ato mund të dënohen publikisht nga të gjithë, në një shtet të së drejtës, askush nuk mund të vihet në rolin e organit të ndjekjes penale apo të gjykatës. Vlen gjithashtu të sjellim në vëmendje ndaj çdo simpatizanti apo përfaqësuesi të subjekti zgjedhor, se vetëgjyqësia¹⁶ dënohet penalisht sipas Kodit Penal (Neni 277), ndërkohë që nëse si rrjedhojë e kësaj veprë kanë ardhur dhe pasoja të tjera të dënueshme penalisht, ato sanksionohen sipas figurës përkatëse, në dispozita të tjera të këtij Kodi.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i bën gjithashtu thirrje çdo zgjedhësi që në respekt të dinjitetit të tij por dhe të ardhmes së vendit që aspiron, të mos e shesë votën (e cila gjithashtu dënohet penalisht) apo të mos ndikohet nga asnjë mënyrë apo mjet frikësimi apo intimidimi, që potencialisht mund të çënojë vullnetin e tij për të votuar lirisht, qoftë kur këto kryhen nga persona edhe brenda familjes. Kodi Zgjedhor ju garanton që të ushtroni lirisht dhe në fshehtësi të drejtën e votës, në ambientet e dhomës së fshehtë, brenda Qendrës tuaj të Votimit.

Integriteti i kandidatëve për deputet, në zbatim të ndalimeve të ligjit për dekriminalizimin nr.138/2015

14. Në fokus të monitorimit të KShH-së është dhe pastërtia e integritetit të kandidatëve të propozuar në 5 Qarqe¹⁷, si detyrim që rrjedh nga legjislacioni në fuqi i dekriminalizimit¹⁸. Në funksion të gjetjeve sa më të plota, të cilat do të bëhen publike pas zgjedhjeve, KShH aktualisht nështë në fazën e marrjes dhe përpunimit të informacionit cilësor dhe sasior përkatës, nga organet përgjegjëse si Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Të dhënat e deritanishme evidentojnë se nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të 564 kandidatëve për deputetë, në 5 qarqe të vendit, indiciet që kanë nxitur KQZ-në për të kërkuar

¹⁶ Vetëgjyqësia - Neni 277 i Kodit Penal “Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

¹⁷ Në pamundësi për të siguruar të dhënat për 5 Bashkitë (Malësi e Madhe, Dibër, Berat, Lezhë dhe Pogradec), të dhënat janë përpunuar mbi bazë Qarqesh ose Zonash Zgjedhore (Shkodër, Dibër, Berat, Lezhë dhe Korçë).

¹⁸ Ligjet nr. 137/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të miratuara në vitin 2015.



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme, kanë qenë të dhënat e dokumentuara nga vetë subjektet në formularët e tyre të dekriminalizimit. KQZ ka kërkuar verifikim nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme për 31 kandidatë në rang vendi, nga muaji Mars 2021, nga të cilët 8 kandidatë garues në qarqet objekt monitorimi. Pjesa më e madhe e kandidatëve të subjekteve zgjedhore më të mëdha (PS, PD-AN dhe LSI) kanë reflektuar në formularë të dhëna konkrete mbi procedime penale në vendin tonë apo praktika dëbimi në shtetet e huaja. Ekspertët e KShH-së kanë konstatuar rastin e 1 kandidati të një prej subjekteve në qarkun Lezhë se ka referuar se ndaj tij është caktuar masë sigurimi personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e cila rezulton të jetë revokuar më pas, por në formularin e vetëdeklarimit nuk ofrohen detaje provuese mbi procedimin penal¹⁹. Në përgjithësi, vërehet se roli i publikut në ofrimin e kontributit nëpërmjet vënies në lëvizje të organeve kompetente për procesin e dekriminalizimit mbetet në nivelet të ulëta, çka reflekton dhe eventualisht, njohje jo të mirë të kandidatëve. Gjatë periudhës së monitorimit të këtij procesi rezulton se vetëm në rastin e 1 kandidati pjesë e listës së 5 qarqeve objekt monitorimi është përfunduar procesi i verifikimit nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme duke mos gjetur cënim të legjislacionit për dekriminalizimin.

Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ)

15. Koordinatorët lokalë të KSHH-së vëzhguan në Bashkitë përkatëse, ngritjen dhe funksionimin e 30 Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ). Informacionet e siguruar nga monitorimi në terren nuk janë të plota dhe të gjithëanshme, për shkak të aksesit të kufizuar ndaj vëzhguesve të akredituar nga KQZ, në cënim të nenit 7 të Kodit Zgjedhor. Kjo situatë është konstatuar në monitorimin e disa KZAZ-ve (ose janë vërejtur mungesa të prezencës së përfaqësuesve në këto KZAZ, gjatë orarit të tyre zyrtar, pavarësisht vajtjes në mënyrë të përsëritur pranë tyre)²⁰. Në tërësi, KSHH vëren se veprimtaria e disa prej KZAZ-ve ka filluar në tejkallim të afateve të parashikuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve²¹. Me shqetësim vërehet funksionimi i KZAZ nr. 84 në Vlorë, i cili deri më dt. 5 Mars 2021 ka zhvilluar veprimtarinë në mjediset e zyrave të Bashkisë Vlorë²². Duke qenë se disa prej anëtarëve janë funksionarë publikë dhe janë autorizuar për t’u angazhuar në KZAZ, mosprezenca e tyre krijon premisa potenciale për shpërdorim të burimeve njerëzore gjatë procesit zgjedhor. Raportohej të ketë patur gjithashtu zevëndësime të anëtarëve të KZAZ-ve²³. Problematika janë vërejtur edhe lidhur me mungesën e afishimit të indikacioneve mbi emrat e anëtarëve/sekretarit dhe numrat e kontaktit²⁴. Shqetësues është fakti se anëtarët e KZAZ-ve janë trajnuar rreth 2 muaj me vonë

¹⁹ Pavarësisht se kjo vendimmarrje nuk është e formës së prerë, vlerësojmë se në kuadër të transparencës, KQZ mund të kërkonte informacion të detajuar nga organet proceduese mbi këtë vendimmarrje.

²⁰ KZAZ nr. 35 dhe nr. 39 (Bashkia Tiranë), KZAZ nr. 24 (Bashki Durrës), KZAZ nr. 3 (Shkodër) dhe KZAZ nr. 13 (Bashkia Lezhë). Pavarësisht caktimit të orarit zyrtar për funksionimin e KZAZ-ve Orari i KZAZ-ve 09.00 - 13.00 dhe 16.00 - 20.00.

²¹ Bashkitë Pogradec dhe Elbasan kanë filluar në muajin Shkurt 2021

²² Lidhur me këtë fakt është vendosur në dijëni dhe KQZ me aë të raportit periodik të monitorimit të KSHH-së për muajin Mars.

²³ Në Bashkitë Lezhë, Berat, Malësi e Madhe, Gjirokastrë, Elbasan, Vlorë, Korçë, Tiranë, Shkodër, Kukës, Fier dhe Durrës

²⁴ Në KZAZ nr. 12 dhe 13 (Bashkia Lezhë), nr. 66 (Bashkia Berat), nr. 69 (Bashkia Pogradec) dhe nr. 1 (Bashkia Malësi e Madhe), KZAZ nr. 40 (Bashkia Tiranë), KZAZ nr. 2 (Bashkia Shkodër), KZAZ nr. 22, 23 në Durrës,



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

nga data kur duhej të ishin ngritur dhe mbledhur, çka cënon eventalisht cilësinë e administrimit të procesit zgjedhor prej tyre. Vendimmarrjet e KZAZ-ve nuk pasqyrohen rregullisht në Librin e Protokollit²⁵, ose Libri i Protokollit nuk është nënshkruar ose firmosur nga anëtarët,²⁶ ose mbledhjet mbahen shënim në bllokun personal të shënimeve të sekretarit,²⁷ praktika të cilat nuk janë në pajtim të pikave 5 dhe 6 të nenit 22 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 40/2020.

Komisionet e Qendrave të Votimit

16. Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) janë ngritur në të gjitha Bashkitë e monitoruara, por vonesa janë vërejtur në ngritjen e disa KQV-ve nga disa KZAZ²⁸, si rrjedhojë e kohës së gjatë që i është dashur subjekteve politike për të shqyrtuar të metat e konstatuara nga ana e KZAZ dhe kësaj të fundit për të marrë vendim përfundimtar. Në përputhje me nenin 62, pika 2, vërehet ngritja e QV të posaçme në institucionet e burgjeve dhe ato të shëndetit publik²⁹. Nga verifikimi i disa prej praktikave me dokumentacionet mbështetëse mbi anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve, vërehet se kanë arsim të mesëm dhe jo me arsim të lartë, fakt i cili bie ndesh me nenin 38 pika 2 të Kodit Zgjedhor³⁰. Trajnimet e anëtarëve të KQV-ve kanë nisur më datë 18.04.2021 dhe vijnë ende. Për shkak të përfshirjes së platformës online të raportimit nga ana e anëtarëve të KQV-ve dhe përdorimit të kamerave e identifikuesve biometrikë, KShH vlerëson se këto trajnime janë të vonuara. Gjithashtu vërehet se pjesëmarrja në këto trajnime konstatohet e ulët në disa prej Bashkive të monitoruara³¹, si dhe jo e përfaqësuar për disa prej subjekteve politike.

Ky raport pasqyrues i gjetjeve paraprake të fazës parazgjedhore u përpilua në kuadër të zbatimit të dy nismave, përkatësisht "Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen" mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian dhe "Drejt integritetit më të mirë në kandidatëve, për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme", me mbështetjen financiare të Republikës Federale Gjermane. Gjetjet dhe rekomandimet e pasqyruara në këtë raport janë përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Europian dhe Republikës Federale Gjermane.

KZAZ-të nr. 47, 49 në Elbasan, ku si arsye është referuar mungesa e materialeve nga KQZ ose e mungesa e vullnetit të anëtarëve për të ofruar detajet mbi emrat apo kontaktet e tyre.

²⁵ KZAZ nr. 13 Lezhë, KZAZ nr. 21, 22 në Durrës,

²⁶ KZAZ nr. 12 Lezhë.

²⁷ KZAZ nr. 13 Lezhë.

²⁸ Vonesat janë evidentuar në KZAZ nr. 39 në Tiranë (26/03/2021), KZAZ nr. 2 në Shkodër (03/04/2021), KZAZ nr. 74 në Korçë (09/04/2021), KZAZ nr. 18 në Dibër (03/04/2021), KZAZ nr. 74 në Korçë (09/04/2021). Kurse, në KZAZ 83 në Vlorë shfaqen problematika duke qënë se subjektet zgjedhore kanë dërguar listat e propozimeve të tyre, por nuk kanë bashkëngjitur dokumentacionin mbështetës për kandidatët. Si rrjedhojë e vonesës në depozitimin e propozimeve nga partitë politike, me efektin domino, ka pasur pamundësi nga KZAZ-ve të marrin vendim brenda afatit 5 dite të parashikuar në nenin 36/2 KZ.

²⁹ Realizuar në Bashkinë Lezhë për IEVP Shënkoll (QV nr. 0748 – 139 zgjedhës) dhe Bashkinë Berat (Njësia Administrative Otlak), në Bashkinë Durrës për IEVP Durrës (QV nr. 14222 - 184 zgjedhës), dhe Bashkinë Korçë IEVP Drenovë (QV nr. 37071 - 268 zgjedhës)

³⁰ KQV të ngritura nga KZAZ nr. 19 (Bashkia Dibër), KZAZ nr. 18 (Bashkia Bulqizë) dhe KZAZ nr. 1 (Malësi e Madhe).

³¹ Bashkitë Malësi e Madhe; Korçë dhe Fier